

## Cështja C-450/93

**Eckhard Kalanke**

**kundër**

**Freie Hansestadt Bremen**

(Referenca për një vendim paraprak

nga Bundesarbeitsgericht)

(Trajtim i barabartë për burrat dhe gratë — Direktiva 76/207/EEC — Neni 2(4) — Promovim —

Kandidatët e kualifikuar në mënyrë të barabartë të gjinive të ndryshme —

Prioritet i dhënë grave)

Opinioni i Avokatit të Përgjithshëm Tesauro dorëzuar më 6 prill 1995 I - 3053

Aktgjykimi i Gjykatës, 17 tetor 1995 ..... I - 3069

### **Përmbledhje e Aktgjykimit**

*Politika Sociale — Burrat dhe gratë punëtorë — Qasja në punësim dhe kushtet e punës – Trajtim i barabartë - Shmangiet - Masat për promovimin e mundësive të barabarta midis burrave dhe grave - Fushëveprimi – Dispozita kombëtare e cila favorizon automatikisht gratë e kualifikuara në mënyrë të njëjlojtë të cilat të konkurrojnë me burrat për promovim në rastet kur gratë janë pak të përfaqësuara – E palejueshme*

*(Direktiva e Këshillit 76/207, Nen. 2(1) dhe (4))*

Neni 2 (1) dhe (4) i Direktivës së Këshillit 76/207 mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë për sa i përket qasjes në punësim, trajnimet profesionale dhe promovimin, dhe kushtet e punës përjashtojnë rregullat kombëtare të cilat, ku kandidatët e gjinive të ndryshme në listën e ngushtë për promovimin janë të kualifikuar në mënyrë të barabartë, automatikisht u japin përparësi grave në sektorë ku këto të fundit janë të nën-përfaqësuara, nën-përfaqësimi konsiderohet se ekziston kur gratë nuk përbëjnë së paku gjysmën e stafit në grupet përkatëse të personelit ose në nivelet e funksionit të parashikuara në organikë.

Neni 2 (4) i kësaj direktive, i cili duhet të interpretohet në mënyrë strikte dhe që siguron se direktiva jepet pa paragjykim për masat për promovimin e mundësive të barabarta për burrat dhe gratë, në veçanti

duke hequr pabarazitë ekzistuese të cilat ndikojnë në mundësitë e grave, është në mënyrë specifike dhe projektohet ekskluzivisht për të lejuar masat të cilat, edhe pse me sa duket çojnë në diskriminim për shkak të gjinisë, në të vërtetë kanë për qëllim eliminimin ose reduktimin e rasteve aktuale të pabarazisë mes meshkujve dhe femrave, të cilat mund të ekzistojnë në realitetin e jetës shoqërore. Ai në këtë mënyrë lejon masa kombëtare në lidhje me qasjen në punësim, duke përfshirë promovimin, të cilat i japin një avantazh të veçantë grave me qëllim përmirësimin e aftësive të tyre për të konkurruar në tregun e punës dhe për të ndjekur një karrierë në mënyrë të barabartë me burrat.

Nje rregull kombëtar i cili i garanton grave pritoritet absolut dhe të pakushtëzuar për caktim ose promovim nuk është masë e një lloji të tillë, duke qenë se shkon përtej promovimit të mundësive të barabarta dhe zëvendësin për të rezultatin – barazinë e përfaqësimit — i cili mund të arrihet vetëm duke e ofruar një barazi të tillë.